



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

THIRRJE PËR APLIKIM

Ftohen të gjithë fermerët e komunës së Prishtinës që të aplikojnë për përkrahje me mekanizëm bujqësor:

1. Furnizimi me rimorkio për shpërndarjen e plehut organik të pulave vojse -ferma komerciale

Kriteret e përgjithshme:

- Të kenë së paku 2000 e më shumë pula vojse ;
- Përfituesi duhet jetë banor rezident i Komunës së Prishtinës dhe objekti (ferma) për vendosjen e pulave vojse dhe pulave për konsumim të mishit të jetë në territorin e komunës;
- Nuk kanë të drejtë përfitimi fermerët dhe anëtarët e ngushtë në bashkësi familjare, të cilët kanë përfiturar në 5 (pesë) vitet e fundit pajisje për shpërndarjen e plehut shtazor apo të plehut të pulave nga Komuna dhe donatorët në bashkëpunim me Komunën;
- Nuk mund të jetë përfitues më shumë se një anëtar i bashkësisë familjare;
- Fermerët të cilët nuk kanë pronën në pronësi familjare, apo shfrytëzojnë toka më qira, duhet të kenë marrëveshje kontraktuese të nënshkruar nga të dy palët të noterizuar) në kohëzgjatje prej 3 viteve;
- Në kohën/ditën e realizimit të kontrollit në teren, mosha e pulave vojse duhet me qenë 16 javëshe, por jo me shumë se 95 javëshe;
- Infrastruktura përcjellëse (mekanizëm përkatës për përdorimin e kësaj pajisje bujqësore-Traktor me fuqi minimale 40 hp(kf);
- Të ketë sipërfaqe të tokës bujqësore minimum 1Ha, (sipërfaqe minimale prej 0.15 Ha e pandarë)
- Fermeri ka të drejtë të aplikoj vetëm për një pajisje.
- Fermerët përfitues të serres gjatë vitit kalendarik 2026 nuk mund të jenë edhe përfitues të mekanizmit bujqësor dhe anasjelltas.

Kriteret specifike:

- Fermerët që kanë numër më të madh të pulave vojse kanë përparësi në raport me ata që kanë numër më të vogël ;
- Përparësi kanë fermerët të cilët nuk kanë qenë asnjëherë përfitues të kësaj pajisje nga Komuna dhe donatorët në bashkëpunim me Komunën;
- Njohuri elementare në fushën përkatëse;
- Fermerët me përgatitje profesionale shkollore (shkolla e mesme bujqësore, fakulteti përkatës);
- Fermerët të cilët kanë ndjekur trajnime përkatëse;
- Gratë fermerë dhe grupet e marginalizuara;
- Madhësia e fermës (sipërfaqja e tokës punuese);
- Prona në pronësi të aplikuesit (fermerit);
- Prona e marrë me qira.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopja e një dokumenti identifikues valid të Republikës së Kosovës;
- Vërtetimi nga shërbimet veterinarë të licencuara nga organet përkatëse;
- Certifikata mbi pronësinë e paluajtshme në afat deri në 6 (gjashtë) muaj;
- Kopja e planit të sipërfaqes punuese;
- Marrëveshja në mes palëve (Kontrata e qiras);
- Dëshmi për përgatitje profesionale –trajnime;
- Kopja e dokumentacionit të Traktorit;
- Deklarata nën betim;
- Vërtetimi i tatimit nga ATK.

Afati i aplikimit është nga 20.05.2026 deri më 22.05.2026. Aplikimi bëhet në objektin e Bashkësisë Lokale në Besi.